KËRKESË
Nr. 935/6, datë 6.10.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Sistemin, asfaltim rruga 'Pjetrushi' pranë varrezave të qytetit, Grudë e Re', Bashkia Shkodër", me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 326,970 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Shkodër.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "arë" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Shkodër, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 326,970 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "SISTEMIM, ASFALTIM RRUGA 'PJETRUSHI' PRANË VARREZAVE TË QYTETIT, GRUDË E RE", BASHKIA SHKODËR

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim						Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
												Arë							
	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. i pasurisë	Z. kadastrale	Indeksi i hartës	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m^2)	Truall (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R
1	Dede		Shkambi	221/10	1965	178-A	ARE	5900	0	2	112	724	270	195,480.00	0	0	0	195,480.00	
2	Mhill	Gjon	Zefi	221/15	1965	178-A	ARE	4000	0	4	69	487	270	131,490.00	0	0	0	131,490.00	
3	Shtet			371	1965	178-A	RRUGE	17000	0	3	41	0	0	-	0	0	0	0	
4	Shtet			438	1869	178-A	RRUGE	9600	0	5	246	0	0	-	0		0	0	
Shuma																		326,970	